



KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë



KRU. "GJAKOVA" SHA. Gjakovë			
Marrë në datën: 24.06.2020			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	1025		

MARRËVESHJE BASHKËFINANCIM

Komuna e Gjakovës	
Republika e Kosovës - Republika Kosova	
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica	
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë	
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove	
Nr./Br.	01 413/01-137 13
Data/Datum	24.06.2020
Gjakovë-Djakovica-Gjakova	

E lidhur me datën 19.06.2020 në mes të palëve:

K.R.U. "Gjakova" Sh.A. - Gjakovë, të cilën e përfaqëson, Kryeshefi Ekzekutiv z. Ismet Ahmeti, në tekstin vijues K.R.U. "Gjakova" dhe

Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson, Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna.

Neni 1

Lënda dhe qëllimi i marrëveshjes

Lëndë e kësaj Marrëveshje Bashkëfinancimi është realizimin e projekteve në Shërbimet e Ujësjetës dhe Kanalizimit për periudhën 01.07.2020 deri me 01.07.2021 në Komunën e Gjakovës, me qëllim të furnizimit të plotë dhe kualitativ të banorëve të Komunës së Gjakovës.

Neni 2

Obligimet e palëve në marrëveshje

1.1 Palët në marrëveshje, Komuna e Gjakovës dhe K.R.U."Gjakova"Sh.A.-Gjakovë u dakorduan që të bashkëfinancojnë në realizimin e projekteve në ndërtimin e rrjetave të reja të ujësjetës dhe kanalizimeve si dhe rehabilitimin e rrjetave të vjetra që do të realizohen në Komunën e Gjakovës, nga K.R.U."Gjakova"SH.A. për periudhën Korrik 2020 deri më Korrik 2021.

1.2 Në realizimin e projekteve si në paragrafin 1.1 të këtij neni, pala në Marrëveshje Komuna e Gjakovës nga buxheti i saj do të participoj me 49% të shumës totale për secilin projekt të financimit të projekteve, ndërsa K.R.U."Gjakova" SH.A. me 51% të shumës totale për secilin projekt të financimit.

1.3.Palet u dakorduan që projektet nuk mund të fillojnë të realizohen pa letër konfirmim financiare nga Komuna e Gjakovës.

1.4. Procedura e prokurimit në realizimin e projekteve për zgjedhjen e operatorit-kryesit të punimeve, do të zhvillohet nga K.R.U. "Gjakova"Sh.A.

1.5. Në vitet në vijim palët Komuna dhe K.R.U. "Gjakova" u pajtuan që ti koordinojnë aktivitetet e parapara për investime, në mënyrë që të planifikohen paraprakisht investimet në sferën e realizimit të ndërtimit të rrjetave të reja të ujësjellësit, si dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese.

Monitorimi i Marrëveshjes se bashkëfinancimit Neni 3

Monitorimi i marrëveshje se bashkëfinancimit do te behet nga Komisioni për pranimin teknik të projekteve në përbërje prej tre anëtarë, dy anëtarë nga K.R.U."Gjakova" Sh.A. dhe një anëtarë nga Komuna e Gjakovës .

Neni 4 Zgjidhja e Mosmarrëveshjes

7.1 Në rast të çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me mos përmbushjen e obligimeve që i kanë palët në këtë marrëveshje, palët negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të konsensusit, kontestin në mes të palëve do ta zgjidh Gjykata Kompetente.

Neni 5

7.2 Kjo Marrëveshje është e përpiluar në dy kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbajë nga një kopje.

PALËT KONTRAKTUESE

Kryeshefi Ekzekutiv


Ismet Ahmeti



Kryetari Komunes


Ardian Gjini

